



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 26 datë 26.6.2020

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.6.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, pika 4/a e VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKB nr.26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2020 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar të bashkisë Shkodër për vitin 2020-2022“, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2060, datë 30.01.2020 "Mbi fondet për strehimin për vitin 2020, Shtotjca “B” Subvencionimi i qirasë për banesat e pronarëve socialë në tregun e lirë, materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë me 26 vota Pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Shkodër, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banese me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1	10,700

2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	1	16,000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	1	20,900
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	1	26,500

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit

Denis Lesha

KRYETARE

